



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Departamenti i Kimisë, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, (FSHN) shpall konkurs për 2 (dy) personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2024 – 2025, konkretisht:

- 1 (një) kandidat të kategorisë profesor
- 1 (një) kandidat të kategorisë asistentlektor.

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatëve për secilën kategori janë si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme e të veçanta për personelin akademik të kategorisë *profesor* janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të mbajnë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar”. Titulli i lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse e për Arsimin në Shqipëri,
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet Universitare në fushën e shkencave të mjedisit ose kimike,
3. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna,
4. Kandidati të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata,
5. Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet në përputhje me fushën e tij të studimit.

II. Kriteret të përgjithshme e të veçanta për kandidatin e kategorisë *asistent lektor* janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të kenë përfunduar studimet universitare Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të, brenda ose jashtë vendit në disiplinat kimike ose teknologjike me notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Kandidati duhet të kenë kryer kurse ose kualifikime të tjera brenda dhe jashtë vendit në fushën përkatëse. Rregjistrimi në Doktoraturë është përparësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

3. Kandidati duhet të kenë përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor në IAL (institucionet e arsimit të lartë).
4. Preferohet që kandidati të kenë bërë publikime brenda dhe jashtë vendit në fushën e specialitetit të kërkuar.
5. Kandidati duhet të njohë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore dhe të zotërojnë dëshmi të mbrojtjes së saj.
6. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
7. Kandidati të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
8. Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet në përputhje me fushën e tij të studimit.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti).
7. Raport i aftësisë për punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetsore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve **(09.01.2025 - 20.01.2025)** nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al në adresën:

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

**Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik, Kimia*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht nga Komisioni për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës.